



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija

Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

KQZ PËRGATITET PËR TË APLIKUAR NË ACEEEO

08.05.2009 - Me ftesë të Shoqatës së Zyrtarëve Evropian Zgjedhor (ACEEEO), kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, Z. Zait Xhemajli ka bërë një vizitë zyrtare në selinë e kësaj shoqate në Budapest të Hungarisë, më 5 dhe 6 Maj. Z. Xhemajli është pritur nga Dr. Zoltan Toth, Sekretar i Përgjithshëm i ACEEEO-së dhe bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë vizitës, është biseduar lidhur me bashkëpunimin mes dy palëve dhe njëkohësisht, është nënshkruar një marrëveshje të përgjithshme bashkëpunimi me qëllim që të formalizojnë marrëdhëniet mes dy palëve dhe të përfitojnë nga aktivitetet e përbashkëta që do të organizohen në të ardhmen nga ACEEEO-ja. Po ashtu, kjo marrëveshje ka për qëllim që të dy palët të shkëmbejnë programe dhe aktivitete që kanë të bëjnë me çështjet zgjedhore dhe si fillim, ACEEEO-ja i ka ofruar KQZ-së një trajnim mbi zgjedhjet për anëtarët e KQZ-së i cili planifikohet të mbahet në Meksikë.

Në kuadër të këtij takimi, gjithashtu është biseduar për modalitetet që KQZ-ja të bëhet anëtare e kësaj shoqate. KQZ-ja do të bëjë përgatitjet për aplikim në ACEEEO në një të ardhme të afërt. Vizita, i ka hapur rrugën KQZ-së në arenën ndërkombëtare, gjë që do t'i mundësojë përvoja të reja, bashkëpunim dhe kontakte me të gjithë përfaqësuesit e Komisioneve Zgjedhore Evropiane dhe më gjerë.